

VENDIM
Nr. 33, datë 10.2.2025

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 20/10/6 kV PËR VITIN 2025

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.2.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 722/1 prot., datë 10.2.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV për vitin 2025 dhe përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për shoqëritë Ujësjellës-Kanalizime për vitin 2025”,

konstatoi se:

- Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 370 prot., datë 27.1.2025, protokolluar në ERE me nr. 722 prot., datë 29.1.2025, ka paraqitur në ERE kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2025, për klientët FMF të lidhur në nivelet e tensionit 6/10/20 kV (klientë të rëndësisë së veçantë), si dhe për shoqëritë ujësjellës-kanalizime të lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV dhe 35 kV.

- Në përputhje me VKM-në nr. 456/2022, KESH sh.a. do të vazhdojë të mbulojë sasinë e kërkuar të energjisë elektrike për klientët e FSHU sh.a., të cilët shërbehen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit edhe për vitin 2025. FSHU sh.a., në aplikimin e saj të datës 27.1.2025 (shkresa nr. 370 prot.), protokolluar në ERE me nr. 722 prot. më 29.1.2025, ka bashkëngjitur, gjithashtu, korrespondencën e KESH sh.a. (nr. 7349/1 prot., datë 31.12.2024), ku, siç parashikohet në VKM-në 456/2022, evidentohet se KESH sh.a., pas analizave për Programin Ekonomik-Financiar të vitit 2025 dhe parashikimeve për periudhën 2026–2029, ka paraqitur projeksionet e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë në Këshillin Mbikëqyrës. Ky i fundit miratoi Programin Ekonomik-Financiar të KESH sh.a. për vitin 2025 dhe parashikimin për vitet 2026–2029 me vendimin nr. 10121/1, datë 31.12.2024.

- Referuar të dhënave të përcjella nga shoqëria, rezulton se çmimi mesatar i ponderuar për blerjen e energjisë elektrike për klientët FMF të lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, për vitin 2025 do të jetë 12.00 lekë/kwh.

- Në vijim, mbështetur në “Metodologjinë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të miratuar me vendimin nr. 201 të Bordit të ERE-s, datë 4.12.2017, të ndryshuar, paraqesim përlogaritjen e kryer për përcaktimin e çmimit FMF për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV. Komponentët e marrë në konsideratë janë:

- **Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike** për periudhën 1 janar 2025–31 dhjetor 2027 e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 279, datë 16.12.2024, “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 janar 2025–31 dhjetor 2027” prej 0.85 lekësh/kwh.

- **Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelet e tensionit 20/10/6 kV**, në zbatim të vendimit të Bordit të ERE nr. 288, datë 23.12.2024, “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022”, vijon të jetë 3.99 lekë/kwh.

- **Kostot administrative**, prej 1.06 lekësh/kwh.

- **Kthimi për riskun prej 3%** (i aplikuar mbi çmimin mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë për mbulimin e kërkesës për energji elektrike) në vlerën 0.36 lekë/kwh për kategorinë e klientëve të lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV.

- Në zbatim të metodologjisë së sipërcituar, si dhe bazuar në të dhënat e aplikimit, nga përlogaritja e kryer nga ERE rezultojnë se çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV është si në tabelën e paraqitur më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV për vitin 2025		
	Njësia	Çmimi
CBEt Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Lekë/kWh	12.00
Pr Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Lekë/kWh	0.36
CA Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06
TRr Tarifa e përdonimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85
TSHt Tarifa e përdonimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	3.99
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr* CBEt + TRr + TSHt + CA	Lekë/kWh	18.26

- Mbështetur në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimet e shoqërisë, rezultojnë se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV për vitin 2025 do të jetë 18.26 lekë/kwh.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për periudhën 1.1.2025–31.12.2025, prej 18.26 lekësh/kwh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV.

2. Çdo ndryshim në elementet përbërëse të çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga Bordi i ERE-s.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti